



NJOFTIM SHPALLJE PUBLIKE PËR QIRADHËNIE

Njësia Nr	Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Emërtimi i Asetit	Vendndodhja e asetit/pronës (Adresa)	Sipërfaqja m ²
Njësia 1	IGK Ballkan	Lokali nr. 2-përballë QKMF-Suharekë	Lagja Fidanishte (kompleksi i banesave të NSH "IGK Ballkan"), lokali përballë QKMF- Suharekë	65 m ²
Njësia 2	IGK Ballkan	Lokali nr. 4	Lagja Fidanishte (kompleksi i banesave të NSH "IGK Ballkan"), lokali prapa Market Beni-Suharekë	65 m ²
Njësia 3	"Gradjevinar Shtërpçë"	Ndërtesa Administrative Shtërpçë	Prona ndodhet përgjatë rrugës Brezovicë – Shtërpçë	Objekt prej 120m ²

Kushtet e përgjithshme:

1. Periudha e Qiradhënies është deri në 1 vit me mundësi vazhdimi gjithashtu edhe ndërprerje për shkaqe të privatizimit.
2. Ofertat bëhen në mënyrë individuale për secilën njësi veç e veç.
3. Ofertat duhet të dorëzohen personalisht apo në rast që dorëzohen në emër të qiramarrësit pala duhet ta ketë autorizimin e noterizuar tek noteri.
4. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur (një zarf – një ofertë për një njësi), dorëzohen në Zyrën Rajonale të Prizrenit.
5. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: nr i Njesisë, emri i Nsh-së, Emërtimi i Asetit dhe vendndodhja e asetit.
6. Në rastet e qiradhënies në vlera mbi € 1,000 mujore, para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet nga ofertuesi fitues të sjellë garancionin bankar (jo letër zotimi nga banka) në lartësinë e kontratës.
7. Për dorëzimin e ofertës duhet të përdoret **Formulari për Dorëzimin e Ofertës** i cili mund të merret në Zyrën Rajonale të AKP-së, apo të shkarkohet nga ueb-faqja: www.pak-ks.org
8. Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit fitues të njësive përkatëse do të jetë çmimi i ofertës më të lartë.
9. Ofertat do të pranohen me **13.06.2018** prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç.
10. Zarfet do të hapen publikisht në Zyrën Rajonale të Prizrenit me datë **13.06.2018** në ora 12:15
11. Ofertat përmes faksit nuk do të pranohen.
12. Sipërfaqet e prezantuara më lartë janë të përafërta dhe të dhënat më të sakta me fotot e njësive si dhe informatat tjera relevante mund të merren në Zyrën Rajonale të AKP-së në Prizren.
13. Të dhënat e detajuara për pronat lëndë e ofertës mund të merren në Zyrën e AKP-së në Prizren, Rruga "Pushkatarët" No 9, Prizren; në telefonin: 029-226-480 apo në email adresën: info@pak-ks.org
14. Kjo shpallje përpos që do të publikohet në gazeta ditore në gjuhën shqipe dhe serbe në Kosovë do të publikohet edhe në ueb faqen zyrtare të AKP-së.
15. Në çmimin e ofertës totale duhet të përfshihen të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë, përfshirë edhe TVSH 18%, etj.)

Pagesa e Qiramarrjes:

Ofertuesit fitues është i obliguar që të paguaj shumat me pagesa të rregullta paraprake mujore, duke filluar me pagesën e parë të caktuar në fillimin e kësaj Kontrate të Qirasë, dhe, deri në masën që është e zbatueshme, me pagesa mujore në vijim, të caktuara në të njëjtën ditë të muajit vijues, (apo më herët në rast se data e pagesës së parë apo ndonjë pagesë tjetër mujore rastis të jetë ndonjë festë publike.

Ofertuesit fitues për toka bujqësore pagesën e qiramarrjes duhet të bëjnë pagesë totale brenda afatit pesë ditë pune pas marrjes së kontratës për tokën që është subjekt i qiradhënies.

Dispozita të përgjithshme:

Pronat e këtyre njësive të paraqitura më lartë ofrohen për dhënie me qira "ashtu siç janë" dhe "ku janë". Ofertuesit kanë përgjegjësinë të verifikojnë përshkrimin dhe kushtet e njësive/lokaleve (gjendjen faktike) dhe AKP respektivisht

Autoriteti i Likuidimit i NSh-ve përkatëse do të konsiderojë se ofertuesit kanë dijeni të mjaftueshme në lidhje me pronat e ofruara për qiradhënie dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë pengim të posedimit/shfrytëzimit eventual.

Ofertuesit me ndalesë ofertimi:

- Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore, ndaj të cilëve Agjencia apo NSh -ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirim e pronës dhe kompensimin e dëmeve eventuale;
- Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

**Ofertat do të pranohen me 13.06.2018 prej orës 10:00 – 12:00
në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç në:**

**Zyra Rajonale e AKP-së në Prizren
Adresa: Rr. Pushkatarët Nr.9, (në Shatërvan) në Prizren
Tel: 029-226-480
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org**